



Pranuar / Received	17 - 06	1	viti / god year
Organizuesja / Organizational Unit	3163/2021	Shtesa / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
115			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A .nr.434/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari- kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca- anëtarë si dhe Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, duke u bazuar ne Aktgjykimin me numër A.nr.2532/2019 të datës 18.05.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, të pranuar me datë 21.05.2021, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.262/2019 të datës 30.04.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi rruga "Luan Haradinaj" ish Pallati i Mediave kati 14 Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 16.06.2021, mori këtë

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.262/2019 e datës 30.04.2019 e parashtruar nga ankuesi

Arsyetim

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ka shpallur konkursin e brendshëm me datën 03.01.2019 për pozitën e lire të punës „Udhëheqës i Sektorit për Raportim, Informim dhe Bashkëpunim“, në Drejtorinë për Vleresimin e Gjendjes së Mjedisit në Agjensinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, me numër të referencës MMPH-1/2019, pas marrjes së autorizimit nga DASHC/MAP, të datës 28.12.2018.

Ankuesi ka aplikuar për pozitën e lire të punës „Udhëheqës i Sektorit për Raportim, Informim dhe Bashkëpunim“, në Drejtorinë për Vleresimin e Gjendjes së Mjedisit në Agjensinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, i cili është kualifikuar për të hyrë në listë të ngushtë, të datës 17.01.2019 nga Komisioni Përzgjedhës për Shërbimin Civil të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Me njoftimin e datës 01.02.2019 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka

shpallur kandidatin e suksesshëm për vendin e „Udhëheqës i Sektorit për Raportim, Informim dhe Bashkëpunim“, në Drejtorinë për Vleresimin e Gjendjes së Mjedisit në Agjensinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.

Ankuesi i pa kënaqur me mos përzgjedhjen e tij për vendin e punës „Udhëheqës i Sektorit për Raportim, Informim dhe Bashkëpunim“, në Drejtorinë për Vleresimin e Gjendjes së Mjedisit si dhe kundër njoftimit të datës 01.02.2019 për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm, me datën 22.02.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 976/19 në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me datën 14.03.2019 përmes emalit ka njoftuar kandidatin se është bërë shtyrja e vendimit në pajtim me nenin 135 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin përmes emalit të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me datën 30.04.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbime Civile të Kosovës, me pretendimet ankimore së procedura e rekrutimit për pozitën „Udhëheqës Sektori për Raportim Informim dhe Bashkëpunim“, nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e zhvilluar në kundërshtim me dispozita ligjore të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës dhe akteve ligjor për zbatimin e tij.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 03.05.2019 me numër të protokollit 2126/2019 e ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ndërsa Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me datë 08.05.2019 me numër të protokollit 2740/2019 ka dërguar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 17.06.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 19.05.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2532/19 me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 17.06.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 30.04.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.262/2019 e datës 30.04.2019 me numër protokollit 20942019 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin me numër A.nr.2532/2019 të datës 19.05.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Ankesë e datës 22.02.2019 drejtuar



Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Kërkesa për punësim e me shkresat e bashkangjitura; Certifikatë e datës 18.05.2004; Diploma e datës 26.02.2009; Vendimi i datës 20.03.2014; Vendimi i datës 09.10.2015; Vërtetimi i datës 21.09.2011; Vërtetimi i datës 20.09.2011; Formuari për Vësimin e Rezultateve në punë; Raporti për Gjendjen e ajrit; Vendimi i datës 17.01.2019 për Themelimin e Komisionit për zgjedhës; Konkursi i datës 03.01.2019; Autorizimi i datës 28.12.2018 i Ministrisë së Administratës Publike; Kërkesa për punësim e me shkresat e bashkangjitura; Kontrata e marrëdhënies së punës; Akt emërimi i datës 13.04.2016; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë; vërtetim i datës 14.02.2017; Certifikatë e datës 04.02.2013 diplomë e datës 17.06.2016; Regjistrimi i Aplikacioneve të Pranuar; Përcaktimi i kriterëve për përfshirje në listën e ngushtë; Raporti mbi selektimin e kandidatëve; Vlerësimi Individual i kandidateve për vendim e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Testi me shkrim; Përmbledhja e Vlerësimit Individual; Përmbledhja e vlerësimit e rezultuarve të punës; Njoftimi për kandidatin e Suksesshëm; Vendimi i datës 31.01.2019; Njoftimi i datës 17.06.2019 i Këshillit; Përgjigje në ankesë e datës 08.05.2019 me numër protokoll 2227/2019 me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me njoftimin e datës 01.02.2019 për kandidaten e përzgjedhur për vendin e punës „Udhëheqës i Sektorit për Raportim, Informim dhe Bashkëpunim“, në Drejtorinë për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit në Agjensinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës i cili pretendon se komisioni për zgjedhës nuk i ka bërë vlerësimin real të kualifikimit dhe përvojës së punës në krahasim me kandidaten e suksesshëme si dhe rezultatet e testit me shkrim dhe të intervistës me gojë, gjegjësisht dallimet në poentim në mes kryesuesit dhe anëtareve të komisionit në testim me gojë ku ankuesi është vlerësuar me më shumë pikë nga kryesuesi se kandidati i përzgjedhur.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të shkresave të lëndës të dorëzuara nga ankuesi, si dhe organi i punësimit ka konstatuar që procedura e rekrutimit për pozitën e punës „Udhëheqës i Sektorit për Raportim, Informim dhe Bashkëpunim“, në Drejtorinë për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit në Agjensinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës të shpallur me datë 03.01.2019 nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, është bërë në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, ku është përcaktuar se: *“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mosdiskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”,* me rastin e shpalljes së konkursit të brendshëm, të datës 03.01.2019 pasi ka marrë autorizimin nga Ministria e Administratës Publike DASHC/MAP me datën 24.05.2017.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se në konkursin e shpallur të datës 03.01.2019 nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për pozitën „Udhëheqës i Sektorit për Raportim, Informim dhe Bashkëpunim“, në Drejtorinë për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit, kriteret e konkursit kanë qenë:

- *Diplome Universitare: nga lëmi i fakultetit të shkencave të natyrës, shkencave mjedisore, shkenca shoqërore, gazetari, edukim dhe të ngjashme si dhe*
- *Të ketë së paku katër (4) vite përvojë punë, etj.*



Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit kundër përzgjedhjes së kandidatës së suksesshme të datës 01.02.2019 për pozitën „Udhëheqës i Sektorit për Raportim, Informim dhe Bashkëpunim”, në Drejtorinë për Vleresimin e Gjendjes së Mjedisi, është i paqëndrueshëm sepse ankuesja është përfshirë në listën e ngushtë me datë 22.06.2017 dhe komisioni përzgjedhës e ka vlerësuar drejtë në pajtim me nenin 28 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 neni 2, 3, 4 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil ku thuhet: *“Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kritereve në vijim:...,1.2. përvojën e punës”, secili anëtar vlerëson kandidatin në secilin kriter. Numri maksimal i secilit kriter është 20 pikë. Numri maksimal është 80, ndërsa minimumi për vazhdimin e kandidatit në procedura të tjera është 40 pikë. Kandidatet, të cilët nuk arrijnë numrin minimal të pikëve përjashtohet nga fazat e tjera të përzgjedhjes”.*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, po ashtu ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit deri në përzgjedhjen përfundimtare, ka vepruar drejtë duke bërë vlerësimet e testit me shkrim dhe me gojë si për ankuesin, po ashtu edhe për kandidaten e përzgjedhur duke vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 37 dhe 39 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe në bazë të vlerësimeve të kandidatëve: ka arritë gjithsejtë 391 ose 78.2% të pikëve të përgjithshme nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, ndërsa ankuesi ka arritë gjithsejtë 348.5 ose 69.7 të pikëve të përgjithshme nga testi me shkrim dhe intervista me gojë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka shqyrtuar edhe pretendimin e ankuesit se komisioni përzgjedhës nuk i ka bërë vlerësimin real të kualifikimit dhe përvojës së punës në krahasim me kandidaten e përzgjedhur, ky pretendim është i paqëndrueshëm sepse kandidatja e përzgjedhur ka kualifikim dhe përvojë të punës të kërkuar në pajtim me kriteret e konkursit të datës 03.01.2019 siç është kërkuar *„Diplome Universitare: nga lëmi i fakultetit të shkencave të natyrës, shkencave mjedisore, shkenca shoqërore, gazetari, edukim dhe të ngjashme si dhe „Të ketë së paku katër (4) vite përvojë punë”*, sepse kandidatja e përzgjedhur në vendin e punës „Udhëheqës i Sektorit për Raportim, Informim dhe Bashkëpunim”, në Drejtorinë për Vleresimin e Gjendjes së Mjedisi, Selvie Raci posedon Diplome të studimeve themelore të lëshuar me datë 17.07.2013 nga Universiteti i Prishtinës me të cilën dëshmohet se ka kryer Fakultetin Juridik me datë 21.12.2012 dhe mori titullin Baçellor i Drejtësisë, si dhe me përvojë të punës sipas Vertetimit të datës 14.02.2017 të lëshuar nga Udhëheqësja e Divizionit për Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me të cilën dëshmohet se ka qenë e punësuar nga data 14.10.2009 deri me datën 11.04.2013, në pozitën „Asistente Administrative”, ndërsa nga data 12.04.2013 - vazhdon në pozitën „Zyrtare e Lartë për koordinimin e çështjeve juridike, ligjore dhe administrative” në Agjensinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës -Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si rrjedhojë vlerësimi i aplikacionit të ankuesit dhe kandidatës së përzgjedhur është bërë në pajtim me nenin 28 paragrafin 1 nën paragrafit 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *“Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kritereve si në vijim: 1.1arsimimi dhe kualifikimi profesional, përvoja e punës, shkathtësia dhe aftësitë dhe elementet e tjera të meritë”*, kështu që vlerësimi i aplikacionit është bërë në bazë të parimit të meritës pasi që të dy kanë plotësuar kushtet e konkursit dhe kanë përvojën e punës siç kërkohet në konkursi, mbi këtë bazë pretendimi i ankuesit është i pabazuar.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të Formularit Form. MAP-SHCK-10 të Renditjes Përfundimtare të Kandidatëve, ka konstatuar që kandidatja e përzgjedhur pas vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë është vlerësuar me 78.2% të pikëve, ndërsa ankuesi është renditur i treti (3) në listë me 348.5 ose 69.7 të pikëve, andaj mbi bazë të kësaj në shërbimin civil emërohen kandidatët që kanë numërim më të madhe të pikëve sipas nenit 40 paragrafit 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *“Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë”*, gjegjësisht përzgjedhja e kandidatës është bërë në pajtim me dispozitat e lartëcekura.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, procedurën e rekrutimit dhe përzgjedhjes së kandidatit, për pozitën *„Udhëheqës i Sektorit për Raportim, Informim dhe Bashkëpunim”*, e ka zhvilluar në pajtim me nenin 11 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: *„Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve.*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit sipas nenit 10.1 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda A.Nr. 434/2021

Rushit KAJTAZI
[Signature]
Procesmbajtës

Malsore GASHI - BAJRAKTARI
[Signature]
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit,
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit;
- Arkivit të KPM SHCK-së